



DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT (DKA)

SQARIME PËR TË GJITHË KANDIDATËT

Të nderuar kandidatë,

Komisionet përkatëse të Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) të Komunë së Prishtinës, të hënën, më 17 mars 2014 e kanë bërë përzgjedhjen e 3 kandidatëve për intervistim, të cilët kanë aplikuar sipas konkursit të datës 13 shkurt 2014.

Përzgjedhja është bërë në monitorimin e shoqërisë civile dhe sipas procedurës së përzgjedhjes, kriterëve të paraseleksionimit dhe udhëzimeve administrative përkatëse, dokumente të cilat tashmë kanë qenë publike për të gjithë kandidatët, por janë në dispozicion të të gjithë kandidatëve edhe këtu në ueb faqe.

Për të qenë plotësisht transparent, ne po e publikojmë edhe databazën e kandidatëve, në mënyrë që secili mund ta shoh se kush është përzgjedhur për intervistim e kush jo. Janë 2 databaza. Databaza e parë i ka të dhënat për kandidatët që kanë aplikuar në pozitat prej 1-17 dhe në të dytën janë kandidatët që kanë aplikuar në pozitat 18-38 sipas konkursit të shpallur (kanë mbetur pa u përzgjedhur kandidatët që kanë aplikuar për pozitën 27 dhe sapo komisioni përkatës ta bëj një gjë të tillë do të informoheni). Po ashtu, ka pasur disa kandidatë që në formularin e aplikimit nuk kanë treguar se në cilën pozitë kanë aplikuar, prandaj dhe në mungesë të të dhënave aplikacionet e tyre nuk janë shqyrtuar (këta kandidatë janë në databazën e parë – sheet 0).

Për secilën pozitë (kodi i pozitës sipas konkursit) të dhënat gjenden në databaza (në sheets sipas kodit).

- Fillimisht janë marrë në konsideratë vetëm kandidatët e rangut të parë sipas Udhëzimit Administrativ (UA) 20/2013 dhe nëse ka pasur kandidatë të mjaftueshëm të kësaj kategorie, atëherë kandidatët e rangut tjetër nuk janë marrë parasysh.

- Kandidatët që kanë pasur më shumë vite të studimeve dhe ECTS kredi, janë marrë parasysh para kandidatëve të tjerë.

- Kandidatët e përzgjedhur për intervistim janë kandidatët e parë, rreshtat e të cilëve janë hijezuar fund e krye me ngjyrë të kuqe.
- Kandidatët që janë të hijezuar fund e krye me ngjyrë të kaltër janë kandidatë që janë përzgjedhur për t'u intervistuar në ndonjë pozitë tjetër, meqë kanë aplikuar në më shumë se një pozitë, në ndërkohë që mund të ftohet në vetëm një vend/pozitë për intervistim.
- Kandidatët që janë të hijezuar me ngjyrë të kuqe vetëm në kolonën **K**, janë kandidatë që kanë qenë të kualifikuar si kandidatë të rangut të parë sipas udhëzimit administrativ 20/2013, por të cilët nuk kanë arritur të përzgjidhen për intervistim, meqë sipas kriterëve të paraseleksionimit janë përzgjedhur 3 kandidatët që kanë marrë më së shumti pikë.

Për të ruajtur konfidencialitetin e kandidatëve, nëpër databaza janë vetëm emrat e mbiemrat e kandidatëve që janë përzgjedhur për intervistim, ndërsa për kandidatët e tjerë janë vetëm numrat e protokollit, në mënyrë që secili të mund t'i shoh pikët e tij/saj në ndërkohë që të tjerët nuk mund ta dijnë identitetin e tyre.

Kandidatët e përzgjedhur për intervistim së shpejti janë kontaktuar ose do të kontaktohen nga komisionet përkatëse për t'u informuar me detajet e intervistimit (vendi, dita, data dhe koha e intervistimit).

Ne jemi të vetëdijshëm që gjatë futjes së të dhënave në databazë mund të jenë bërë gabime, dhe kjo është njerëzore, meqë kemi pasur gjithsej 1760 aplikacione, prandaj i inkurajojmë kandidatët që vërejnë se ka pasur ndonjë gabim le të na shkruajnë, në mënyrë që ne të ndërmarrim hapat e nevojshëm për të bërë korrigjimet e duhura.

Kushdo që konsideron së është bërë ndonjë gabim ose i është bërë padrejtësi mund të ushtrojë ankesë me shkrim në DKA (vetëm me shkrim – jo takim) dhe DKA-ja do të kthejë përgjigje brenda afatit ligjor. Sidoqoftë, para se të ushtroni ankesë ju lusim që paraprakisht t'i lexoni me vëmendje këto sqarime dhe të gjitha dokumentet që janë të bashkëngjitura këtu (rregullat, kriteret dhe UA-të përkatëse).

Së bashku me këto sqarime janë të bashkëngjitura edhe dokumentet e poshtë-përmendura:

2. Konkursi nga DKA - 13.02.2014
3. Procedura e përzgjedhjes
4. Kriteret e paraseleksionimit
5. Databaza e kandidatëve - Pozitat 1 – 17
6. Databaza e kandidatëve - Pozitat 18 – 38
7. UA - Procedura e zgjedhjes së personelit
8. UA - Normativi për Kudarot Profesionale

Ju falënderojmë për mirëkuptim!

Me respekt,

Jusuf Thaçi

Drejtor i DKA-së

Komuna e Prishtinës